



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 169 prot.

Kamëz, më 22.12.2021

V E N D I M

Nr. 137 Datë 22.12.2021

MBI

“ SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË KAMËZ ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.12.2021, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.127 Datë 17.12.2021 mbështetur në gërmën "f", të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, Ligjin nr. 9632 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa"...., i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 32, datë 31.12.2013 "Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar Ligjin nr.10081, datë 23.02.2009 "Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar, VKM nr.408 datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" i ndryshuar, Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje", i ndryshuar, Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Ligjin nr.9385, date 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", i ndryshuar, Ligjin nr.9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, Ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit, Ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për administrimin dhe vlerësimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz si vijon:
Miratimin e paketës fiskale si më poshtë vijon:

Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

A. TAKSAT VENDORE

PAKETA FISKALE (TAKSAT, TARIFAT VENDORE PËR BIZNESIN DHE FAMILJARËT) PËR VITIN USHTRIMOR.

Llojet, baza tatimore ,kategorizimet dhe nën kategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

➤ Çfarë prezanton paketa fiskale?

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Kamëz dhe Planit të Zhvillimit të territorit.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësiive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
 - Taksim i drejtë;
 - Tarifim mbështetur në kosto;
 - Klasifikim i biznesit, lloji i aktivitetit;
 - Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve;

PËRKUFIZIME

Paketa fiskale përcakton nivelin e taksave dhe tarifave vendore, procedurat dhe strukturat e ngarkuara të Bashkisë Kamëz për vjeljen e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

“Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik.

“Tarifë” janë të ardhurat që krijohen nga njesia vendore për shërbimet publike që ofron, të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore, dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për leshimin e dokumenteve të tjera, për te cilat ato kanë autoritet të plotë.

A.2. TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Mbështetja ligjore: Ligji Nr.9632, dt.30.10.2006 “Për Sistëmin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Taksa mbi mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- 1.Taksa mbi ndërtesat.
- 2.Taksa mbi tokën bujqësore.
- 3.Taksa mbi truallin.

A.2.1. TAKSA MBI NDËRTESESËN

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t’u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:

- i. Vetëdeklarimi
- ii. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ASHK)
- iii. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore

Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njesisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në metodologji.

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj si më poshtë;

Kategoritë dhe nënkategoritë	% e bazës së taksës
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim	0.05%
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	0.20%
-Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.	30% e shkallës së taksës përkatëse

Tabela 2. Nivelet e taksës së ndërtesës sipas kategorive



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

A2.1.1 Ndërtesa banimi në pronësi apo përdorim.	Njesia	Vlera e References	Shkallë në përqindje e Taksës	Çmimi për lek/m ² /vit
a) Ndërtesa banimi (52000x0.05%) sipas ligjit	Lekë/m ² /vit	52 000 lekë/m ²	0.038%	20
b) Per ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652, date 23.12.1992 (70% e 52 000 lekë)	Lekë/m ² /vit	36 400 lekë/m ²	0.038%	13
c) Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	Lekë/m ² /vit	52 000 lekë/m ²	0.038%	20
d) Ndërtesa të dyta banimi (për të gjitha shtëpitë e tjera)	Lekë/m ² /vit	52 000 lekë/m ²	0.05%	26
A2.1.2 Ndërtesa të tjera në pronësi apo përdorim që nuk shërbejnë për banim.	Njesia	Vlera e References	Shkallë në përqindje e Taksës	Çmimi për lek/m ² /vit
a) Për çdo njësi tregtare, shërbimi, etj, (1.5 here x 52.000 leke çmimi i banesës x 0.2 %)	Lekë/m ² /vit	78,000 lekë/m ²	0.26% (+30 %)	203
b) Per parkime te mbuluara dhe bodrume (70% e 52 000 leke)	Lekë/m ² /vit	36,400 lekë/m ²	0.2%	73
c) -Per parkime te hapura -Pishine e hapur -Ambjente sportive te hapura (fusha futboll, minifutbolli, basketbolli,	Lekë/m ² /vit	15,600 lekë/m ²	0.2%	31



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

volejbolli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to) -Porte dhe aeroporte (30% e 52 000 lekë)				
ç) - Për veprimtari industriale (prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to) -Per veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura (50% x 52 000 lekë)	Lekë/m ² /vit	26,000 lekë/m ²	0.26% (+ 30%)	68
c) Për veprimtari bujqesore dhe blektorale (30% e 52 000 lekë)	Lekë/m ² /vit	15,600 lekë/m ²	0.26% (+ 30%)	41
e) Ndërtesa të pajisura me leje për banim, të papërfunduara, në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit (30% x koston e ndërtimit)	Lekë/m ² /vit	32,113 lekë/m ²	0.05% x 30%	5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

f) Ndërtesa të pajisura me leje për shërbime, të përfunduara, të shkelje të afatit të lejes së ndërtimit (30% x koston e ndërtimit)	Lekë/m ² /vit	32,113 lekë/m ²	0.2% x 30%	19
--	--------------------------	-------------------------------	------------	----

A2.1.3 Taksë pasurie për objektet	Lekë/m ² /vit	
Puse shpimi, impiante të përpunimit të ujit, depo ujë, depo uji të Ujësjellësit; Impiante të përpunimit të mbetjeve urbane.	203 /vit	lekë/m ²
Shtylla të tensionit të ulët (TU), tensionit të mesëm (TM), të Tensionit të Lartë (TL), nënstationet elektrike.	203 /vit	lekë/m ²
Për antenat e radio komunikimit të cilat janë vendosur në taracat e objekteve private, si dhe për çdo antenë tjetër të telefonive celulare të vendosura brenda territorit juridiksional të Bashkisë Kamëz.	203 /vit	lekë/m ²

Shënim: Bashkia Kamëz, në zbatimin të niveleve të shkallës së taksës sipas ligjit, ka aplikuar për **kategorinë familjare** uljen 30 (tridhjet) për qind. Pasi bazuar në ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22 “Taksa mbi ndërtesat” si dhe VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme (ndërtesa)...I ndryshuar.” çmimet referuese të ndërtesave në territorin e Bashkisë Kamëz, sipas aneksit 1 të VKM-se nr. 132, datë 07.03.2018 për bashkinë Kamëz është 52,000 lekë/m² dhe do llogaritet si më poshtë:

$52000 * 0.05\% = 26 \text{ Lekë/m}^2$ psh; $100\text{m}^2 \times 52000 \text{ Lekë/m}^2 \times 0.05\% = 2.600 \text{ Lekë/vit}$
<i>me uljen prej 30% që aplikon Bashkia, kjo takse llogaritet:</i>
$52000 * 0.038\% = 20 \text{ Lekë/m}^2$ psh; $100\text{m}^2 \times 52000 \text{ Lekë/m}^2 \times 0.038\% = 2.000 \text{ Lekë/vit}$



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

-Për ndërtesat e dyta nuk aplikohet kjo ulje, do paguajne sipas ligjit 0.05% ($52000 \times 0.05\%$) * m2.

↓ Në kategorinë “Ndërtesa banimi”

-Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllim jo fitimprurës nga qytetarët (banorët rezident apo jo rezidnet) vetëm për qëllim banimi.

-Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi siç e parashikon ligji (në përdorim apo shfrytëzim).

-Në rastet kur konstatohet nga grupet e punës në terren apo nga informacione të marra në rrugë zyrtare se;

a- nje pronarë ose përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Bashkisë Kamëz është banor faktik por jo me leje banimi pranë kësaj bashkie do jetë subjekt i të gjitha taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale, taksës së ndërtesës do të llogaritet siç e parashikon ligji ($52.000 \text{ leke} \times 0.065\% = 33.8 \text{ lekë/m}^2$) me rritje prej 30%.

b- nje pronarë ose përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Bashkisë Kamëz por nuk është banor faktik dotinënshtrohen vetëm taksës së ndërtesës siç e parashikon ligji ($52.000 \text{ leke} \times 0.065\% = 33.8 \text{ lekë/m}^2$) me rritje prej 30%.

↓ Në kategorinë “Ndërtesa për tregti dhe shërbime”

-Ndërtesa për shërbime tregtare, profesione të lira etj. të ngjashme me to: Do të përfshihen të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të mbyllura dhe njësi tregtare dhe shërbimi të çdo lloji etj. të ngjashme me to.

- Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi.

- “Të tjera”: Përfshihen të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme:

- Ndërtesa për aktivitete social-kulturore, arsimore e shkencore: përfshihen të gjitha ndërtesat njësitë e shërbimit si shkollat, kopshtet, çerdhet, qendrat kulturore, qendrat sociale, ndërtesat shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, sallat e koncerteve, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

✚ “Ndërtesa që përdoren për veprimtari industriale”

- “Ndërtesa industriale” do të përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues të tilla si prodhim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe çdo aktivitet tjetër të ngjashme me to.

✚ Ndërtesa për parkime të mbuluara dhe bodrume

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet për parking të mbyllur dhe bodrumet, fushat e kalçetove të mbuluara, apo ambiente të hapura të mbulluara vetëm nga sipër me llomarine, lavazhet e mbuluara me tendë apo çdo do lloji materiali tjetër që në dokumentat e pronësisë nuk është ndërtesë.

✚ Ndërtesa për parkime të hapura

Në këtë kategori do të përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet për parking në ambiente të hapura, fushat e kalçetove të pa mbuluara.

➤ **Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit**, të destinuar për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientët e hipotekuara si:

- Apartamentë banimi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa banimi”;
- Ndërtesë biznësi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime”.

Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë:

- a) Të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësine e ndërtesës në pronësi/përdorim të tij;
- b) Të dhënat e disponuara nga ASHK-së lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;
- c) Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;
- ç) Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

- d) Të dhënat e ASHK-së për ndërtesat në proces legalizimi;
- dh) Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;
- ë) Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtesë, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;
- f) Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.
- Të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi/përdorim të tij të pasqyruara në sistemin GIS të Bashkisë Kamëz.

Menyra e pagesës

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Për katëgorinë (A.2.1.1) taksa e ndërtesës për familjet paguhet nga të gjithë familjet dhe Agjent Tatimor do të jetë Ujësllës Kanalizime Kamëz sh.a. Familjet të cilat kanë një kontratë me Ujësllës Kanalizime Kamëz do të faturohen cdo muaj ne faturën e UKK në shifër të barabartë për 12 muaj. Pra nga janar vitit korent deri ne janar te vitit pasardhes. Familjet e Bashkisë Kamëz do të mund ta paguajn faturën pranë cdo sporteli të UKK.

Ujësllës Kanalizime Kamëz do të derdhi cdo muaj shumat e arketuara për kete taksë pranë cdo sporteli të Bankave te Nivelit të Dyte në numrin e llogarisë së Bashkisë Kamëz.

Për familjet të cilat nuk kanë një kontratë me UKK kjo taksë do të vilet nga D.T.T.V në bashkepunim me Drejtoritë e tjera bazë të rregjistrit te gjendjes civile të Bashkisë Kamëz si dhe ato familje që janë banore por pa leje banimi të evidentura sipas rasteve.

Ujësllës Kanalizime Kamëz sh.a ne rolin e agjentit tatimor perfiton 2.5% te arketimeve totale nga kjo taksë.

Pët të vijuar puna për mbledhjen e taksës së ndërtesës për kategorinë familjare do të paguhet në vlerën fikse vjetore (100m²x20 leke/m²)= 2.000 (dymijë lekë) lekë për çdo familje, deri kur të përditësohen të dhënat e regjistrit qendror të pasurive të paluajtshme (kadastra fiskale) siç e parashikon ligji. Pastaj do bëhet rakordimi i pagesave +/- për diferencen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

-Pra çdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do llogaritet duke marrë për bazë sipërfaqen prej **100 m²** (sipërfaqe e prezumuar) për çdo rast me çmimet e tabelës së mësipërme aneksi A.2.1.1

Likuidimi i Taksës së ndërtesës:

-Për kategorinë **A.2.1.1 Ndërtesa banimi** bëhet brenda datës 30 Dhjetor të vitit ushtrimor.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjare. *(pika 1 e Nenit 114 të ligjit Nr 9920 date 19.05.2008 i ndryshuar)*

-Për kategorinë **A.2.1.2(Ndërtesa të tjera që përdoren për qëllime biznesi)** bëhet brenda datës 20 Prill.

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas kësaj date është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

✓ **Arkëtimi i taksës së ndërtesës për kategorinë A.2.1.2.**

Si bazë për llogaritjen e detyrimit për këtë taksë për subjektet është vlera e ndërtesës së shfrytëzueshme për qëllime aktiviteti. Kur biznesi i krijuar (regjistruar) gjatë vitit merr në përdorim ndërtesa të krijuara në vitet paraardhëse, taksa e ndërtesës llogaritet dhe arkëtohet e plotë si detyrim vjetor, pavarësisht nga data e regjistrimit të tij. Në rastet kur kjo taksë është paguar njëherë dhe vërtetohet me mandat pagese, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore bëhet paraqitja e dokumentit të arkëtitimit të taksës për ndërtesën, zbritet detyrimi për vitin kalendarik dhe vendoset në dosjen e biznesit.

Për çdo ndryshim të ligjit do reflektojmë Paketën Fiskale.

***Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës:**

- a) pronat e shtetit dhe të njëjve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore

- Baza ligjore: Ligji 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 22 “Taksa mbi ndërtesat”; ligji nr.181/2013, datë 28.12.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; Ligjin 142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,” Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 10. Ligjin 106/2017, datë 30.11.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,” Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar; VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si taksapagues personin fizik apo juridik që ushtron aktivitet, pavarësisht pronësisë së objektit.

- ❖ Struktura për vjeljen e taksës përkatëgorinë A.2.1.2 (Ndërtesa të tjera që përdoren për qëllime biznesi) është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkinë Kamez.
- ❖ Struktura për vjeljen e taksës përkatëgorinë A.2.1.1 do të jetë Agjenti Tatimor Ujësjiellës Kanalizime Kamëz SHA dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkinë Kamez (për familjet që nuk kanë një kontratë me UKK).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

A.2.2. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi për caktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë pronësinë.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

Niveli i taksës është si vijon:

A2.2 Taksat mbi tokën bujqësore	Njesia	Taksa
Taksa mbi tokën bujqësore për territorin e Bashkisë Kamëz, ku sipas klasifikimit të Ministrisë Bujqësisë është kategori e III-të.	Lekë/ha/vit	4.500

Shënim: Përjashtim bëjnë rastet kur sipërfaqja e tokës bujqësore, taksapaguesi paraqet dokumentat ku në çertifikat pronësie është trull i nënshtruar kategorisë A.3 taksa mbi truallin.

Struktura për vjeljen e taksës sipas pikave A2.2 është Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Liçensave dhe Kadastrës në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera.

A.3. TAKSA MBI TRUALLIN

Baza e taksës mbi truallin, është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit për qëllime banimi dhe për qëllime biznesi. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë.

Në rast të mungesës të dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë ku ndodhet trualli.

Kategoritë minimale të truallit për Bashkinë Kamëz jepen në tabelën e mëposhtme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Taksa mbi truallin	Njesia	Taksa
a) Taksa mbi truallin për qytetarët	Lekë/m ² /vit	0.18
b) Taksa mbi truallin për bizneset	Lekë/m ² /vit	15.6

Niveli i taksës caktohet në lekë për m²: Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria TTV-së kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Struktura për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera.

A.4. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person.

Niveli tregues i taksës është si në tabelën e mëposhtme:

Taksa e fjetjes në hotel	Njesia	Taksa
Hotel me 4-5 yje	Lekë/natë fjetje/përson	105
Bujtinë, fjetinë, motël dhe çdo njesi tjetër akomoduese	Lekë/natë fjetje/përson	35

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e të cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Detyrimi derdhet për Bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

A.5. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

1. Baza e taksës është vlera në lekë sipas preventivitqë kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejës së ndërtimit.
2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) % të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate konçensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit Ndërtesa (me shume se familjare) duke përfshirë fabrika dhe magazina.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtimesve për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e koston mesatare të banesave të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:

a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndërtimit në infrastrukturë është në masën 3 % të vlerës së investimit,

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombetare, të porteve, areporteve, tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji , përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit ,por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto e rehabilitimit nuk është përfshirë në preventivin e investimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimive të reja është 0.5% e vlerës së investimit.

Shënim: Për Aktin Normativ Nr.3, datë 2.10.2019 për disa shtesa ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar Neni 1. pas pikes 8,të nenet 27, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimet e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasoje e fatkesësive natyrore, të përcaktohen me "Vendim të Këshillit të Ministrave ", neni 36/1 Dispozitë tranzitore, për sa mësipër të datës 21 shtator 2019, përjashtohen nga detyrimi për pagesen e taksën e taksës së ndikimit në infrastrukturë".

Shënim: Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".

Shënim: Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Shënim: Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.

Baza e taksës: Niveli taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit.

Struktura për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Për gërmen c. Të piken 3 (Ndërtesa në proces legalizimi) Struktura për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

A.6. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, në m² sipas vërtetimit të pronësisë, pronësia e se cilës transferohet, kurse për pasuritë e tjera vlera e shitjes se tyre sipas kontratës noteriale. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 %. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Niveli i taksës sipas aneksit nr 3 të Ligjit 9632 datë 30.06.2008 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar është si më poshtë vijon:

Kategoritë/Nënkategoritë	Niveli i taksës
1 Ndërtesa banimi	100
2 Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime	300
3 Ndërtesa të tjera	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është ASHK, e cila në rolin e Agjentit të Taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

A.7. TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme:

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashkia Kamez
----	-------------------	-----------	------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

I	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) deri në 2 m ²	Ieké/m ² /vit	0
a			
b	■ mbi 2 m ² deri 10 m ²		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Ieké/m ² /vit	7,000
	•me ndriçim të thjeshtë	Ieké/m ² /vit	11,500
	•elektron ike	Ieké/m ² /vit	15 000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	Ieké/m ² /vit	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	Ieké/m ² /vit	9 775
	-elektron ike	Ieké/m ² /vit	12 750
Ç	mbi 20 m ² deri 40 m ²		
	-e thjeshte (pa ndriçim)	Ieke/m ² /vit	3 850
	•me ndriçim të thjeshtë	Ieké/m ² /vit	6 325
	-elektron ike	Ieké/m ² /vit	8 250
d	mbi 40 m ²		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	Ieké/m ² /vit	2,800
	-me ndriçim te thjeshte	Ieke/m ² /vit	4 600
	•elektron ike	Ieké/m ² /vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave në orientim		
	-Tabela identifikuese	Ieké/m ² /vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	•e thjeshtë (me/pa ndriçim)	Ieké/m ² /vit	13 500
	-Elektronike	Ieké/m ² /vit	27 000
IV.	Tabela ne funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese banderola etj		
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	Ieké/m ² /ditë	1,000

SOARIM: PËR TË GJITHA TABELAT PËR QËLLIME IDENTIFIKIMI APO REKLAMIMI TË CILAT NDODHEN JASHTË TERRITORIT TË OBJEKTIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI, SUBJEKTI PARAQET KËRKESË ME SHKRIM PRANË Drejtorisë përkatëse, e cila pasi shqyrton kërkesën e subjektit për leje, vendos për dhënien e saj ose jo. Në lejen e lëshuar detyrimisht përcaktohen vendi i ndodhjes, lloji i tabelës, përmasat etj . Një kopje e lejes së lëshuar dorëzohet në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Kjo e fundit përllogarit dhe ndjek arkëtimin e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

taksës së reklamës/tabelës për vitin kalendarik nga muaji korrent i vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në leje.

Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

A.8. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës **30 të çdo muaji**, për llogari të organëve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njërive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komunë, bashki) të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Baza e taksës: Është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej **5 (pesë)%** të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, **25 %** të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore.

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organët tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

A.8.1. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:
 - a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
 - b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
 - c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
 - ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

Shënim:Këto të ardhura janë të bazuar në ligjin nr.68/2017 Për Finacat e Vetëqeverisjes Vendore i ndryshuar.

B. TARIFA VENDORE PER INFRASTRUKTUREN ARSIMORE

Tarifes Vendore për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizike ose juridikë, vendas ose të huaj, qe banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit te Bashkise se Kamezës.

Niveli i tarifës sipas kategorive dhe nenkategorive është si vijon:

Nr	Kategorite	Niveli i Tarifës		
		BV	BM	VIP
		Leke /vit	Leke/vit	Leke/vit
I	Familjaret	500		
II	Biznesi	BV	BM	VIP
a	Shitje me pakice e shumice	2,000	6,000	10,000
b	Njesiprodhimi	2,000	6,000	10,000
